



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 06 dhjetor 2023, në mbledhjen e XVIII-të (tetëmbëdhjetë)-e jashtëzakonshme, mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 11:05.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë;

(Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Syla; Mrika Thaçi), bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishme ishin edhe; z.Fatlum Osmani-Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF; znj.Adelinë Stublla Drejtoresh e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; z.Pajtim Balaj Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, konstatoi kuorumin ku prezent ishin të gjithë anëtarët/et e KPF-së, theksoi, materialin e keni marrë me kohë të gjithë, andaj mund të vazhdojmë me rendin e ditës.

U konstatua se Njëzëri përkrahet që të vazhdohet me punës sipas rendit të ditës dërguar me thirrjen dhe materialit përkatës.

1. Propozim vendimi për faljen e tatimit në pronë për vitin tatimor 2023

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, duke u bazuar në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronë, i cili është miratuar së fundmi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komunave i'u mundësohet që të falin obligimet e tatimit në pronë për vitin 2023 deri në vlerën 100 €.

Do të thotë kjo vlen për të gjithë tatimpaguesit të cilëve do t'iu falet fatura e tatimit në pronë për vitin 2023, mirëpo vetëm deri në vlerën 100€ e që nënkupton se në rast se NN personi ka faturën e tatimit në pronë për vitin 2023 mbi 100 € ai duhet të paguaj vlerën tjetër si diferencë.

Po ashtu ka shumë qytetarë të cilët e kanë paguar tatimin në pronë në vitin 2023, mirëpo ajo shumë do t'i kompensohet në faturën e vitit 2024 e që nënkupton se faturën e vitit 2024 nuk kanë nevojë ta paguajnë në rast se vlera e faturës është nën 100 €, por nëse është mbi 100 € duhet ta paguajnë vetëm diferencën mbi këtë shumë.

Pra kjo është arsyeja e thirrjes së kësaj seance duke marrë për bazë edhe afatin e caktuar që e ka përcaktuar Ministria e Financave, andaj propozoj që kjo pikë e rendit ë ditës të mbështetet dhe t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne Grupi i LDK-së e mbështesim këtë propozim vendim për faljen e ngarkesave tatimore për vitin 2023 në lartësinë e caktuar sikurse në propozim vendim edhe pse në një fazë të mëhershme kur kemi diskutuar këtu në Kuvend ne kemi pasë një propozim tjetër që të falet komplet tatimi në pronë për vitin 2023, mirëpo ka vendosë dikush tjetër kështu që Ligji është miratuar në atë formë që mundësia e faljes të jetë deri në 100 €, kështu që ne e mbështesim këtë fale.

Për çdo lehtësim që ka të bëjë me lehtësimin e jetës së qytetarëve gjegjësisht lehtësimin e kësaj situatë jo të mirë ekonomike që po kalojmë, ne e mbështesim.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht që si Grup i LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim, konsiderojmë se është shumë i arsyeshëm në radh të parë sepse ka të bëjë me aspektin financiar ku një pjesë e familjeve sigurisht se kanë vështirësi për t'i kryer obligimet e tyre ligjore.

E potencoj edhe drejtori i DBF-së se një pjesë e tatimpaguesve i kanë kryer obligimet tatimore për vitin 2023, mirëpo ajo shumë deri në 100 € sigurisht që do të jetë paradhënie në vitin pasues, prandaj konsiderojmë se propozim vendimi është shumë i mirë, dhe tani më aspekti ligjor i cili më parë ishte kontestues është zgjidhë nga Gjykata Kushtetuese, kështu që e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim me vendim të prerë në mënyrë që pastaj të bëhet i ekzekutueshëm duke u nisë edhe nga fakti që e përmendi edhe drejtori i DBF-së që afati kohorë i caktuar që të merret vendim është më së largu deri më 08.12.2023.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim që pagesa deri në 100 € t'i falet çdo tatimpaguesi të Komunës së Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë vërehet se disponimi i të gjithëve në këtë Komitet që ky propozim vendim t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim, andaj e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit, mbështetet Propozim vendimi në fjalë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe njëkohësisht Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e caktuar për datën 08 dhjetor 2023.

2. Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare Klubin e Futbollit K.F. “Llapi 1932” SH.P.K. Podujevë.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS-së, e paraqiti këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, para vetës keni një kërkesë e cila ka ardh në DKRS nga Klubi i Futbollit “Llapi”, kërkesë në të cilën nuk ka qenë e specifikuar shuma e mjeteve buxhetore që kërkohet, e që ndoshta nuk është shumë e mjaftueshme për Klubin por këto janë mundësitë buxhetore që kemi si DKRS nga buxheti i subvencioneve, prandaj rekomandimi jonë ka qenë që subvencionimi të bëhet në vlerë 20,000.00€ për këtë vit.

Sigurisht se do të shohim mundësitë që t'i ndihmojmë edhe në vitin tjetër për shkak se KF “Llapi” ka treguar suksese të vazhdueshme edhe në vitet e kaluar dhe në këtë vit është pretendent, ndoshta ndër 2-3 pretendentët kryesor për të fituar titullin, prandaj propozoj edhe njëherë që ky propozim i imi t'i rekomandohet Kuvendit me përkrahjen e KPF-së, ndërsa diskutimet tjera mund t'i zhvillojmë në seancën e Kuvendit të Komunës.

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV-ës e përkrahim mbështetjen financiare në vlerë 20,000.00€ për KF “Llapin” dhe i dëshirojmë suksese.

znj. Arnisa Sylejmani, theksoi, edhe ne Grupi i LDK-së e përkrahim që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim. Diskutimet tona do t’i bëjmë edhe në mbledhjen e Kuvendit.

z. Bashkim Sylja, theksoi, natyrisht që edhe ne Grupi i PDK-ës e mbështesim propozim vendimin për subvencionimin e Klubit të Futbollit “Llapi” në shumë 20,000.00€.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën e hedh në votim që t’i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit dhe i Komitetit për Politikë dhe Financa konstatoi se Njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e Komitetit, mbështetet kërkesa e propozuar për ndarje të shumës 20,000.00€ ndihmë / subvencion për Klubin e Futbollit K.F. “Llapi 1932” për ushtrimin e aktiviteteve dhe zhvillimin e garave në Albi Mall Superligën e Kosovës, dhe njëkohësisht Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen e caktuar për datën 08 dhjetor 2023.

Kryesuesi i Kuvendit dhe KPF-së e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15

**Procesverbalin e mbajtën;
Enis Sheholli**

**Nr. Prot. 01-060/04-0085962/23
Podujevë,
06 dhjetor 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**